




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 205/18

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k, & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE: NSH “Spana” & NSH “Veterina” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vaksionimi i gjedheve, kafshëve te imëta dhe qenve shtëpiak”, me nr. 616-18-1598-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datë: 30.05.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k, & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vaksionimi i gjedheve, kafshëve te imëta dhe qenve shtëpiak”, me nr. 616-18-1598-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET njoftimi për dhënien e kontratës i AK-së /Komuna Prishtinë/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Vaksionimi i gjedheve, kafshëve te imëta dhe qenve shtëpiak”, me nr. 616-18-1598-2-2-1, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k. & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 19.03.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 06.04.2018, ku kanë marrë pjesë dy (2) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k. & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, si tenderues i eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt:03.05.2018.

Njoftimi për dhënien e kontratës nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 04.05.2018.

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatorët ekonomik: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k. & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, me dt: 04.05.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 08.05.2018, autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim e operatorit ekonomik: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k. & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k. & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 15 Maj 2018, me nr. 205/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Vaksionimi i gjedheve, kafshëve te imëta dhe qenve shtëpiak”, me nr. 616-18-1598-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Shkelje të nenin 39, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.05.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues - profesionale, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Ekspertja Shqyrtuese - profesional në raportin e dt: 22.05.2018, në lidhje me pretendimet ankimore të OE: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k, & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, ka sqaruar:

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është shkelur Neni 39 Sqarimi i tenderëve i RrUOPP gjegjësisht Pikat 39.3 dhe 39.5, Eksperti sqaron këto pika të ankesës janë të qëndrueshme pas që OE ankues në ofertën e tij ka ofruar këto të dhëna për kontrata:

- për kontratën me Komunën e Fushë-Kosovës me titull “Vaksionimi i kafshëve dhe shpezëve” me nr. 612 17 103 236, kontratë publike në vlerë 9,790.00 euro, ka referencë të lëshuar me datë 04.01.2018 ku shihet edhe vlera e kontratës,
- për kontratën me Komunën e Fushë-Kosovës me titull “Vaksionimi i kafshëve dhe shpezëve në territorin e Fushë-Kosovës” me nr. 6120 16 042 221, kontratë publike në vlerë 9,975.00 euro, ka referencë të lëshuar me datë 24.11.2017 ku shihet edhe vlera e kontratës,
- për kontratën me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë me titull “Shërbimet veterinare në terren – Vaksionimi masiv tek gjedhet Lot 34 – Komuna e Graçanicës” me nr. 40800/16/023/215, kontratë publike me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në vlerë 2,836.50 euro në të cilën nuk shkruan data e fillimit apo përfundimit të kontratës, nuk ka referencë apo raport të pranimit të bashkangjitur,
- për kontratën me Komunën e Fushë-Kosovës me titull “Vaksinimi i kafshëve dhe shpezëve në Komunën e Fushë-Kosovës” me nr. 6120 15 026 236 në vlerë 9,910.00 euro, ka referencë të lëshuar me datë 23.08.2016 ku shihet edhe vlera e kontratës,
- për kontratën me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë me titull “Shërbimet veterinare në terren – Vaksionimi masiv tek gjedhet Lot 34 – Komuna e Graçanicës” me nr. 40800/16/004/215, kontratë publike me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në vlerë të përafërt 41,200.00 euro e cila fillon me datë 15.04.2016 dhe përfundon me datë 14.04.2019, nuk ka referencë apo raport të pranimit të bashkangjitur.

Andaj, në bazë të kësaj Eksperti sqaron se gjithsej vlera e referencave të ofruara të përshkruara më lartë është 29,675.00 euro, andaj AK ka mundur që të kërkojë sqarime sipas Nenit 72 të LPP-së gjegjësisht Nenit 39 të RrUOPP për vlerën e realizuar për kontratat për të cilat OE ankues nuk ka ofruar referenca apo certifikata të pranimit siç është kërkuar në DT.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjja në pretendimin e sipërpërmendur 1), të anulohet Njoftimi për dhënie të kontratës i Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues – KK-Prishtine, me datë: 22.05.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: “Preventiva Vet” sh.p.k. “Diagnoza Vet” sh.p.k, & NTSH “Mala Farm” - Prishtinë, me datë: 22.05.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 30.05.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, ekspertja profesionale e OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Jupolli deklaroi: Duke qëndruar në tërësi pran ankesës së dorëzuar në OSHP me datë 15.05.2018, konsiderojmë se AK ka bërë shkelje të ligjeve pozitive të cilat e rregullojnë fushën e prokurimit publik. Konkretisht AK nuk e ka marr për bazë nenin 72 të LPP dhe nenin 39.3 të RRUOPP-së, me çka ka bërë lëshime të cilat kanë rezultuar që grupi i OE-ve Preventiva dhe tjerët të eliminohen. Grupi i OE-ve ka pranuar aktin përcjellës nga OSHP me datë 22.05.2018, në të cilën ka qenë raporti i ekspertit shqyrtues, të cilin e përkrahim në tërësi, në të cilin ka shpjeguar qartë shkeljet e AK-së dhe e ka arsyetuar mendimin e saj lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues Preventiva dhe të tjerët. Para fillimit të kësaj seance nga zyrtarët e OSHP na është dhënë një kopje e një emali të dërguar nga ekspertja znj.Prebreza, e dërguar me 30.05.2018 tek OSHP, në të cilën thuhet se ajo ndërron mendimin e saj sa i përket ekspertizës së dhënë. Në këtë kuptim përfaqësuesi i OE-ve konsideron se ekspertja është dashtë të plotësoj ekspertizën e saj me një raport shtesë, të marr pjesë në seancë dhe të jap sqarimet e saj për arsyet e ndërtimit të mendimit. Tutje kërkojmë nga OSHP që në pajtim me ekspertizën e dhënë të refuzoj sqarimin e ekspertes, ta aprovoj ankesën e OE bazua në raportin fillestar të ekspertes, të anuloj njoftimin për dhënie të kontratës dhe që AK ta rivlerësoj

dhe rivendos çështjen nga fillimi. Sa i përket pretendimit se OE nuk i përmbushin kushtet për shkak të kontratave të papërfunduara, kontrata e fundit e OE-ve është e ndarë në katër faza, tri nga të cilat janë të përfunduara, për të cilën OE-të posedojnë dëshmi, të cilat ja kanë dërguar edhe AK-së. Me ato dëshmi tejkalohet shuma e kërkuar në dosjen e tenderit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi përfaqësuesit të AK z.Mekolli deklaroi: AK-KK Prishtinë ka udhëhequr këtë procedurë të prokurimit, gjatë përgatitjes së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit AK ka dhënë disa kushte-kritere që OE-të duhet ti plotësojnë. Kritere këto që kanë qenë shumë të qarta për OE-të. Andaj edhe e konfirmojmë edhe një here se pretendimet e OE ankues lidhur me këtë projekt janë krejtësisht të pabazuara. Që janë krejtësisht të pabazuara e vërteton shkresa-tërheqja e ekspertës ku në shkresën e saj thotë “në bazë të rregullave të UOPPP dhe pyetjeve të shpeshta nr.57 të KRPP kur kërkohen shërbime të realizuara, duhet të merren kontratat e përfunduara. Andaj sipas kësaj ankese e OE duhet të refuzohet”. Një prej kërkesave lidhur me aftësinë teknike profesionale ka qenë “OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit nga koha e publikimit të këtij njoftimi për kontratë në vlerën minimale 40,000€”. Ku është dashtë të dëshmohet me listë të projekteve të realizuara në tri vitet e fundit për shërbim të ngjashme dëshmuar me kopje të referencave apo certifikata të pranimeve. OE ankues ka ofruar një listë të projekteve së bashku me kontrata dhe disa referenca të cilat janë , Vaksinimi i kafshëve dhe shpezëve nga KK Fushë Kosovë me vlerë 9,790€. Vaksinimi i kafshëve dhe shpezëve në territorin e KK Fushë Kosovë me vlerë 9,975€. Po ashtu kontratë me KK Fushë Kosovë vaksinimi i kafshëve dhe shpezëve me vlerë 9,910€. Totali i këtyre kontratave është 29,675€. OE ankues ka ofruar edhe një kontratë për shërbime veterinarë në teren me KK Graçanicë me vlerë 2836.50€, të cilën nuk e dëshmon me referencë apo certifikatë të pranimeve. Edhe po ti kërkohet sqarim për këtë kontratë vlera e kontratave të realizuara është 32.511,50€. Nga kjo shihet se OE ankues nuk përmbushë kushtin e përcaktuar në dosje në vlerë minimale 40,000€. AK ka kundërshtuar mendimin e ekspertit për këtë arsye, eksperti rekomandon që të kërkohet sqarim shtesë nga OE në përputhje me nenin 72 për kërkesën e aftësisë teknike dhe profesionale, çka është në kundërshtim të plotë me LPP. AK edhe një here e konfirmon se në përputhje me nenin 69.4 të LPP-së, kërkesën e parashtruar në dosje të tenderit dhe përgjigjen e KRPP tek pyetjet e shpeshta nr.57 nuk ka kërkuar sqarime shtesë për kontratën me AUV, për arsye se kontrata nuk ka përfunduar. Kjo kontratë përfundon në vitin 2019 dhe si rrjedhojë e kësaj nuk merret parasysh. AK KK Prishtinë kërkon nga panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet si e pabazuar dhe të aprovohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Ne pyetjen e anëtari të panelit shqyrtues drejtuar përfaqësuesit të OE-ankues se kërkesë ka qenë se OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit nga koha e publikimit

të këtij njoftimi për kontratë në vlerë 40,000€. Referenca nga AUV për shërbimet e kryera për kontratën e cila nuk ka përfunduar a e mbulon shumën e kërkuar nga AK? Në përgjigje z.Jupolli deklaroj: gjatë parashtrimit të ankesës kemi prezantuar referencën për tri fazat e përfunduara të kontratës me shumë 13.501€, të përfunduara si shërbime.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z.Jupolli deklaroj: Ne qëndrojmë në tërësi pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe rivendosje.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK i z.Mekolli deklaroj: OE ankues nuk ka ofruar fare referencë apo certifikatë për pranim teknik për kontratën me AUV me rastin e ofertimit, çka ka ofruar OE ankues në OSHP me rastin ankesës nuk dimë. Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarami te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se operatori ekonomik ankues në seancen për shqyrtim kryesor ka prezantuar para panelit shqyrtues deshmitë që i ka ofruar sipas kërkeses së dosjes së tenderit dhe se keto deshmi janë në dosjen e këtij operatori ekonomik që ka ofertuar, ku tek kapacitetet teknike dhe profesionale pika 1 AK ka kërkuar: OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit nga koha e publikimit të këtij njoftimi për kontratë në vlerë minimale 40,000.00 €, Ku OE ankues para panelit shqyrtues ka prezantuar prova të mjaftueshme që ka kryer shërbime në vlerë mbi 40,000.00 € Ndërsa si dëshmi për këtë kërkesë AK-ja, ka specifikuar :Lista e projekteve të realizuara në tri vitet e fundit për shërbime të ngjashme dëshmuar me kopje të referencave apo certifikatave të pranimit, ku OE ankues e ka **listën e projekteve të realizuara** në Oferten e dorëzuar pranë AK-së pasi që AK nuk e ka specifikuar se sa të jete vlera e kësaj liste apo sa projekte duhet të kene të përfunduara Operatorët Ekonomik që ofertojnë, andaj autoritetit kontraktues me rastin e rivlersimit të ofertave është i obliguar që vlersimin e ofertave ta bëjë në bazë të kërkesave të vendosur në dosjen e tenderit dhe një herë mund ta rekomandojë për dhënie të kontratës vetëm operatorin ekonomik i cili i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe ka ofertuar me çmim me të lirë, nëse AK ka paqartësi atëherë duhet të kërkojë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së lidhur me deshmitë e ofruara nga ana e operatorit ekonomik ankues.

Paneli shqyrtues konstaton se në lidhje me kete pretendim ankimor të OE ankues se është shkelur neni 39 Sqarimi i tenderëve i RrUOPP gjegjësisht Pikat 39.3 dhe 39.5, konstaton se AK-ja, në dosje e tenderit tek kapacitet teknike dhe profesionale pika 1 ka kerkuar: OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit nga koha e publikimit të këtij njoftimi për kontratë në vlerë minimale 40,000.00€, si dëshmi për kete kerkë AK-ja, ka aspecifikuar :**Lista e projekteve të realizura në tri vitet e fundit për shërbime të ngjashme dëshmuar me kopje të referencave apo certifikatave të pranimit,** operatori ekonomik ankues si dëshmi për kerkësen e cekur si me lart ka ofruar: : - kontratën me Komunën e Fushë-Kosovës me titull “Vaksionimi i kafshëve dhe shpezëve” me nr. 612 17 103 236, kontratë publike në vlerë 9,790.00 euro, ka referencë të lëshuar me datë 04.01.2018 ku shihet edhe vlera e kontratës, - për kontratën me Komunën e Fushë-Kosovës me titull “Vaksionimi i kafshëve dhe shpezëve në territorin e Fushë-Kosovës” me nr. 6120 16 042 221, kontratë publike në vlerë 9,975.00 euro, ka referencë të lëshuar me datë 24.11.2017 ku shihet edhe vlera e kontratës, - për kontratën me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë me titull “Shërbimet veterinare në terren – Vaksionimi masiv tek gjedhet Lot 34 – Komuna e Graçanicës” me nr. 40800/16/023/215, kontratë publike me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në vlerë 2,836.50 euro në të cilën nuk shkruan data e fillimit apo përfundimit të kontratës, nuk ka referencë apo raport të pranimit të bashkangjitur, - për kontratën me Komunën e Fushë-Kosovës me titull “Vaksinimi i kafshëve dhe shpezëve në Komunën e Fushë-Kosovës” me nr. 6120 15 026 236 në vlerë 9,910.00 euro, ka referencë të lëshuar me datë 23.08.2016 ku shihet edhe vlera e kontratës, - për kontratën me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë me titull “Shërbimet veterinare në terren – Vaksionimi masiv tek gjedhet Lot 34 – Komuna e Graçanicës” me nr. 40800/16/004/215, kontratë publike me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në vlerë të përafërt 41,200.00 euro e cila fillon me datë 15.04.2016 dhe përfundon me datë 14.04.2019, nuk ka referencë apo raport të pranimit të bashkangjitur.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform neni 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Komuna Prishtinë

1x1 OE - "Preventiva Vet" sh.p.k. "Diagnoza Vet" sh.p.k, & NTSH "Mala Farm" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.